KARAVÀ - Jam arbëresh, por sot ngë di të flas si jul

PËRKTHYESI - *Si' è greco, ma nun sape parla' comm'a nuie.*

MARULLO - *E tuttavota tte destingue 'e chesta marmaglia fietosa. Pare nu signore; tene mode avuriuse e 'o cugnome tuio è siciliano!*

PËRKTHYESI - Thotë se ti nëng i gjet këtyre, se duke fisnik e mbiemri yt është sicilian.

KARAVÀ - Karicjet (përkëdheljet) le të ve t'ia bënë gravet të tija te furriku...

PËRKTHYESI - Ja thom?

KARAVÀ - Thuaja!

PËRKTHYESI - *(Kolonelit) Dice ca è annurat'e belle parole soie, ma nun sape nibba. (Prirët te Karavau) I thashë se nderohe për fjalët e bukura, por se nëng di gjë...*

KARAVÀ - *(Përkthyesi)* Por ti me kë je?

PËRKTHYESI - U jam me ata; por ju jini arbëreshë...

MARULLO - *(Me ironi) Bene; pure a isso na dozzana 'e nobbele mazziate, mme raccumanno!*

PËRKTHYESI - Për tyj dymbëdhjetë shkopata "fisnike"! *(Ushatri 1 e sjell te Qendra e kthehet.)*

MARULLO - *(Bulkut) Tu, 'o sacco, nun dice nibba....*

PËRKTHYESI - Ti çë thua?

BULKU - E çë kam të thom! Di vetëm se kisha dy bute verë e këta këtu jerdh'e m'i shkulluan gjithë: më bën një dëm aqë të math se për simjet kam të qëndronj pa ngrënë. Duket sikurse breth kur thom se qëndronj pa ngrënë me verën; por u verë "ha", shes verë, vab!

MARULLO - *Ha confessa' 'e congiurate? Ha ditto ca c'è sott' 'a parola "musti"?*

PËRKTHYESI - *Gnornò, chiagne 'o vino ca ce vevettero... (Bulkut) I thashë se qan verën çë të pinël*

MARULLO - *(Hidbërabet) Ma ca vo' ca mme mpurta d' 'o vino; voglio 'e nomme 'e congiurate!*

PËRKTHYESI - Vera nëng ka interes për 'të; ai do emret e konspiratorëvet.

BULKU - Embret? Nga, u çë di! Ai në do mënd të më pyenj si vilet vreshta, si shtypet rrushti, si bëhet vera, por u ngë di tjera shërbise!

MARULLO - *Ha confessato sta vota?*

PËRKTHYESI - *Gnornò, dice ca 'e potete spia' comme se vennegna e comme se fa 'o vino: nun sape ato!*

MARULLO - *È nu gnurante addonca! Be', mparatelo comme se pigliano 'e bastunate, accusi se nzegna quaccosa!*

PËRKTHYESI - Je një çë nëng di, e ai të mëson ndonjë gjë: të rrahurat! *(Marullo bën gëstin të qeljën brënda Bulkun e Ushtari 1 e bën; pastaj kthehet në skenë.)*

CHINNICI - *Nun vonno parla'!*

MARULLO - *E addonca iammo avante diverzamente... Voglio 'e femmene 'e congiurate: chille cchiù appariscente; purzi pigliat'a scaso. Diffonnete 'e ordene. Spicciateve: 'e voglio cca ampress' ampresso!*

PËRKTHYESI - Do gratë e patriotëvet...

CHINNICI - *Gnorsì. (Ushtari 2) Diffonne 'e ordene.*

USHTARI 2 - *Gnorsì. (E nisët.)*

Skena e trembëdhjetë - ATA, PETA

(Hyn Spilidboni Peta me një trastë; Koloneli sapo e sheh merr pushkën me bajonetën në majë të Ushtarit 3 e kërkon t'ë shponjë për vdekje.)

MARULLO - *Apure tu nun sa' niente? (I thotë Petës.)*

CHINNICI - *(Me shpejtësi i vë përpara mantelën e tij e shpëton të mjerin.) Gnor Culunnello, isso è nu fedele suddeto borbonico!*

MARULLO - *(I jep pushkën Ushtarit 3 e ulët) 'O nomme! Comme se chiamma?*

CHINNICI - *Petta Spiridione! Nu fedele suddeto borbonico...*

PËRKTHYESI - Një nënshtetas i besëm!

MARULLO - *(Qetësobët) Addo' va' cu chella vesaccia?*

PËRKTHYESI - Ku vete me atë trastë?

PETA - Jerdha të më jipjët thelimën t'i qillja ca bukë e ca udhos (djathë) tim biri përjashta...

PËRKTHYESI - *Dice ca vole na licenzia ppe' porta' nu poco 'e pane e furmaggio a figleso 'ncampagna...*

MARULLO - *E ppe' dicere a quaccuno... chillo ca succede accà...*

PETA - *Jeu, cillenza sugnu nu fidili sudditu burbunicu e 'u signuri capitannu...*

CHINNICI - *È overo, patreso, e isso stisso, teneno merete dannanze a soia maiestà 'o re 'e Napule!*

PETA - *Sugnu pi' davveru fidili sudditu...*

MARULLO - *Finarmente nu cristiano ca se fa' capì quanno parla!*

PETA - *Propiu pi' farimi capiri 'i vossia!*

PËRKTHYESI - Ky flet që kuptohet... Thotë se është nënshtetas i besëm... I jati e ai vetë janë të merituarshëm te mbreti i Napolit...

MARULLO - *(Përkthyesit) Nun c'è bisogno ca tu nteppete, pecché ce capemo.*

PËRKTHYESI - Nëng ka bëzonjë të ja prier arbërisht... sepse kuptohen!

MARULLO - *(Petës) E vuie sapete quaccosa 'e cungiurate?*

PETA - *Nenti sàcciu! A nu fidili sudditu borbonicu nun veni nuddu a cuntarici ccosi....*

PËRKTHYESI - Thotë se njëi nënshtetasi burbun mosnjeri i rrëfyer gjë...

MARULLO - *Tutte c'a loggica ste paesane... sieno fedele suddete sieno cungiurate: tutti c'a loggica! Ma vuie site obbreca' a sape' chi è cungiurato e chi no!*

PËRKTHYESI - Arbëreshët janë të gjithë logjikë qoftë nënshtetas të besmë qoftë konspiratorë...

PETA - *Nga, cillenza ri sti tempi cu metti 'i naschi fora!*

PËRKTHYESI - Te ky mot kush vë hundët jashtë...

MARULLO - *Nzomma, vuie nun sapete nibba?*

PETA - *'A santa verità!*

PËRKTHYESI - Ai nëng di gjë: shejtja e vërtetë!

MARULLO - *E vuie 'o sapete c' aggio fatto a cu nun sapeva nibba?*

PËRKTHYESI - E ti e di që i bëri atyre që nëng dinin faregjë?

PETA - *Nga, ra batteria ca ntisi... 'i casi... i vutti... 'u vinu...*

PËRKTHYESI - Tërbimet që gjegji ja zbuluan...

MARULLO - *Bravo, avite 'ntiso; ma abbenché suddeto fedele, nun sapete niente; ite... ite, si 'o capetanio peggia...*

PËRKTHYESI - Ky sado që është nënshtetas i besëm i Burbunit, nëng di faregjë! Ec... me garancinë e kapitanit!

PETA - *Grazi cillenza, grazi!*

MARULLO - *Mma si vedete mosse 'e cungiurate ncampagna... venite a referi'!*

PËRKTHYESI - Në sheh lëvizje të konspiratorëve... do t'ja rrëfyesh!

PETA - *'Un avissi dubbi, cillenza! Ci vasu 'i mani, cillenza! (E niset.)*

PËRKTHYESI - Koloneli s'duhet të ketë ndërdeje e i puth duart...

Skena e katërmbëdhjetë - ATA, BELLO

(Ndihet papritur tumbarini-daullja e Bellot.)

MARULLO - *Ched'è sta tammurriata!*

CHINNICI - *È 'o mbriacone 'e bannitore!*

MARULLO - *Nun sape nibba nimmanco isso? Aggio saputo ca bannieva 'e ordene 'e 'o cummitato... 'O voglio accà! (Kapitani dërgon me gjeste Ushtarin 1 që hyn te Qendra e del me Bellon.)*

BELLO - *(Vjen përpara me tumbarinin. Ka lavoma në fytyrë) "Për urdhër të... lënësiwet... të..."*

MARULLO - *Zitto! (Ushtari 3 i jep një shpëlakë.)*

PËRKTHYESI - Koloneli ka bindje se lëçitësi di ndonjë gjë, përsë këndoi urdhërit e komitetit patriotik... *(Bellot) Qetul!*

BELLO - "U" kam të qetem? Ai (Shënon kolonelin) ka të qetet!

MARULLO - *Tu baie banniato 'e ordene 'e 'o cummitato 'e cungiurate: è overo o no?*

PËRKTHYESI - Ti ke lëçitur urdhërit e komitetit të konspiratorëve: është vërtet a jo?

BELLO - *(Me zër lëçitësi) U bandjar... atë që më thonë... të bandjar! Se kur më thonë... e më mirë kur m'ë thonë me një qelq verë te duart... kur më thonë të bandjar te gjithë Hora urdhërit e ndonjeriu... u e bënjl! (E i bie te tumbarini.)*

MARULLO - (*Hidbërobet*) *A vo' ferni, gliannuloso?*

PËRKTHYESI - Mbaroje, fatkeq!

BELLO - M'e tha mua? (*Mbaron së rrahuri.*)

PËRKTHYESI - E kujt?

MARULLO - *Chi tt' ha dato 'a cummissione 'e bannia' 'e ordene 'e 'o cummitato?*

PËRKTHYESI - Kush t'e tha të lëçitje urdhërit e konspiratorëvet?

BELLO - Kush më dha verën më të mirë! (*Kërkon t'i bienj te tumbarini, por Ushtari 1 e ndalon.*)

PËRKTHYESI - *Dice: chi 'e ha dato 'o vino cchiù togo!*

CHINNICI - *Pp'overo funziona sulo c' 'o vino: nun penzo c'have cunuscenza 'e chillo ca va a bannia'!*

PËRKTHYESI - Ky ec vetëm me verë; kapitani thotë se ky nëng di atë çë lëçit.

MARULLO - *E addonca 'e 'o fazzo cunuscente io e ce rumpo 'e uossa e 'o tammurro!*

PËRKTHYESI - Do të të çanjë eshtrat e tamburin.

BELLO - (*Përfaqon tumbarinin*) Jo, tumbarinit jo; por eshtrat mua mënd të m'i çanjël!

MARULLO - *Ca dice ora?*

PËRKTHYESI - *'O tammurro nun 'o vole rutto, mma 'e uossa sù!*

MARULLO - *Ca mossa nobbele! 'O purtate via e 'o cunzate pp' 'e feste!*

PËRKTHYESI - (*Ndërsa Ushtari 1 qaset e e shtyn brënda, i thotë Bello!*) Duan të të bëjën festën!

BELLO - E përçë, ngjer më nani çë më kanë bërë "vixhilljen" (vigjilen)?

Skena e pesëmbëdhjetë - ATA, USHTARËT, K. MUSAKJA.

XH. KASARÀ, K. BENIÇI, MATIEJA, PILJA, GATUCA

MARULLO - *Capitano, 'e congiurate nun se 'o hanno 'a ride, macare ammucciate dint' 'o ventre d' 'a vacca! Mannate a 'e case chella marmaglia llà dintu.... (Shënon Qëndrën) doppo ca 'e ave' allisciata ppe' bene; accusi mpareno 'a lezzione! Suspennete 'e ricerche... Appruntate na carretta ppe' quando arriveno 'e femmine 'e congiurate; 'e voglio purta' comm' ostaggio 'n Palermo!*

CHINNICI - *Gnors! Do 'e ordene! (Hyn te Qëndra.)*

PËRKTHYESI - Sa të mos qeshin konspiratorët, çë rrinë fshehur mirë, koloneli do të marrënj si peng gratë e tyre e do t'i sjellënj Palermë mbi një qerrel Atyre çë nodhen këtje brënda (*Sbënon Qëndrën*), më parë se t'i lironjë, do t'i mësonjë mirësjelljen...! (*Koloneli ngrëhet nga fronti e sbëtët në mendime strategjikë.*)

USHTARI 2 - (*Hyn me Katerinën Musakja, Jakinen Kasarà, Kunçetën Beniçi e, pak të ndajtura nga ato, me Matien, Pilen, Gatucën*) *Gnor culunnello, 'e femmene!*

PËRKTHYESI - Gratë!

MARULLO - *E 'e ate?*

USHTARI 2 - *'E spurta 'o tenente d' 'a terza cumpagnia. (Ndërkaq Kapitani e Ushtari 1 daljën nga Qëndra. Gjithë rrinë në heshtje.)*

MARULLO - *Bene, addonca via, iammocinne 'n Palermo!*

(*Zonjat nisen shoqëruar nga Ushtari 2 e Ushtari 3, ndërsa koloneli i prin; Matieja, Pilja e Gatuca hyjën brënda Qëndrës shtyjtur nga Ushtari 1 e kapitani mbyll rreshtën.*)

AKTI I TRETË

Baji përpara shtëpisë së Llorencit Spata. Mbështetura te muri dhoqene-ndenjëse guri. Në sfondin djathtas del një rrugicë; majtas dera e shtëpisë së Llorencit.

*Skëna e parë - LLORENCI, NONI JAPK, ARGATI 1,
ARGATI 2, JAPKU, MATIEJA*

(*Veç Maties, çë hyn më pas, tjerët rrinë ulur te dielli, sikurse ka shumë kohë çë flasiën. Janë të lavosur e prandaj mbështjellë me ndonjë fashë. Noni Japk rri ulur më drejt. Japku rri pa folë e gjegjet.*)

ARGATI 1 - *Thomse qëroi, ndienj dhëmbje te kjo shpatullë (E nget).*

ARGATI 2 - *Ti i ndien te shpatulla e u kam eshtrat çarë.*

NONI JAPK - Ju thoni se ë qëroi! U thom se klenë (qenë) burbunët që t'i prunë ato dhëmbje. Ti sheh se sa vete Burbuni të shkojnë gjithqish!

ARGATI 1 - E kur vete Burbuni? Patriotët u fshehën si mitë kurr arrën maçja.

LLORENCI - U fshehën, por ngë vje' më thënë se zborën shpresën.

ARGATI 1 - Patriotë të vërtetë na klemë (qemë)! Na morëm e na i dhanë me gjithë zëmër.

LLORENCI - E ti ndëlgon se në kishën marrë patriotët kish sosur kështu? Si nani i kishën vjerrë te furka! Na, me gjithë se ngë deshëm, bëmë pjesën tënë burrërisht.

NONI JAPK - Atë që bënë Burbunët këtë herë, ngë e kishën bërë kurrë! E ju e dini që vje' më thënë kjo?

ARGATI 1 - Jo. E strote e di?

NONI JAPK - Vje' më thënë se ndihen të dobët, pa siguri, e kur një ngë ë më i sigurtë, atëherë i qaset hera të shuhet! (*Bën gjestin e të shuarit.*)

LLORENCI - Vërtet! Tjerat herë kishën bërë dëme këtu e këtje, por kurrë kishën kërkuar te shtëpitë tona. Këtë herë jerdhën edhe tek na. Ato dy zonja, të mjerat, thom e jëma e e motra e Beniçit, i gjetën te shtëpia jime... Hodhën gjithqish n'ajër t'i kërkojën... Na i kishëm fshehur nën shtrat, në mes dy theseve plot me kashtë...

MATIEJA - (*Del te enti i derës. Ka një sy të zi.*) Nga, ku mënd t'i fshihjëm?! Nën shtrat! Na ngë kemi dhomat e tyre; në kishëm pasur dhomat... i kishëm fshehur më mirë!

ARGATI 2 - Në kishët pasur dhomat... ishët të qozmë (bëgatë) e në ishët të qozmë Lloreu ish avukat e ti ishe zonja Matie! E në yt shoq ish avukat e ti zonja Matie, atë e kishën shkrehur e tyj të kishën qellur (sjellë) Palermë e... na i falesh!

MATIEJA - Në isha zonjë, kisha gëzuar gjellën... e mënd të jetë se isha patriote edhe u! E pra si vej e sosëj... vej e sosëj!

ARGATI 1 - Ti je patriote paraç (njësoj): ngë të ëjtën një sy?

MATIEJA - Se më ëjtën një sy jam patriote? Do t'ja thom avukatit Pjediskalci, kur vjen pameta: këtu përpara ke një patriotel! (*Shënon me gisht syrin. Pastaj hyn te shtëpia.*)

ARGATI 2 - (*Flet me Llorencin*) Sat shoqe i nxijtën syun, disa grave i bën shërbise që ngë mënd të rrëfyhen!

Skëna e dytë - ATA, MAS' SHAVERI

MAS' SHAVERI - (*Hyn nga rrugica, me një kerah mbështjellë në fashë lidhur te qafa me një kordele.*) Mos më rrëfyeni se kini dhëmbje! Këtu duket llaxaretil

LLORENCI - Hora e tërë ë një llaxaret! E më lig se ngë dihet ku van'e sosën jatronjtë!

MAS' SHAVERI - (*Me zër të lartë*) Kjo që the ë e hollë, Llore?: "jatronjtë" të thoshje "patriotët"! Bravol

ARGATI 1 - E që e bandjar (shpall) kështu sikurse munde luftën!

MAS' SHAVERI - E që do të flasjëm dalë? Ka një gjellë që rrimë pa folë! Që sot e para ka flitet me zër të lartë: Burbunët me këto që bënë... kanë sa japjën sahatë! (*Ulet.*)

ARGATI 2 - Tyj ish' e t'e jipjën si nani sahatën!

NONI JAPK - T'uju (ulu), mas' Shave', se të lodhet krahu!

MAS' SHAVERI - (*Nonit Japk*) E zotrote? (*Tjerëvet*) E shihni se noni Japk ë më i drejtë? Kura që i bën Burbunët e ndreqi...

NONI JAPK - M'i kërситën mirë. E u që i thoshja: këtu... këtu... te shpina duhet të m'i jipni... e ata... ngëse kishe mbëhi t'i parkalesjel Rrahjën me gjithë shpirt! Këtu... këtu... fortnei (rrahni) këtu... se në më ndreqni kurrizin... i dërgonj një dhuratë mbretit!

ARGATI 1 - Ngase mbreti ngë bëri gjë t'e ndihëj kur punoj arat e e la të shtrëmohej gjithë, nani kërkoi t'i ndreqëj kurrizin me shkopata!

MAS' SHAVERI - Ë të klahet (qahet) e jo të bridhet...

LLORENCI - E ti ku e le razollin?

MAS' SHAVERI - Ëh... Më parë më morën rrazollin, pra më çajtën krahun: kini sa lëni të ju rritet mjekra!

LLORENCI - Ndërrojëm varver!

MAS' SHAVERI - E te çili ke të veç? Gjithëve ja nxorën rrazojet. Sot klasa e varverëvet ë pa rrazoje!

ARGATI 1 - Në ti kishe folë më pak e ngë kishe vatur këtej e atej

me rrazollin te duart... se kish thirje gjithë Burbunët, nani ngë ishe pa rrazuall e pa shërbëtyrë!

ARGATI 2 - Ai rivolucionën dej t'e bëjë vetëm me një rrazuall!

MAS' SHAVERI - E ju me çë? Me drapre e dikirjane?

LLORENCI - Na e thamë se kjo ngë ish rivolta jonë!

MAS' SHAVERI - E se e the? Në kish zënë festa, ti çë rrije me duart te gajofa? Në Rozolino Pilo...

LLORENCI - Më nxore fjalën ka goja! Si sosi?! Pilo! (*Bën gjestin e rrahjevet çë morën*) Lesh e kundërlesh! E ti çë je varver di atë çë thom!

MAS' SHAVERI - Si sosi? Kur sosi? Festa ngë ka zënë fill! Juve ju duket se sosi! Ju e dijët ku ishën fshehur patriotët te këto ditë?

LLORENCI - Si bëjëm t'e dijëm; na ishëm çë numërojëm shkopatat e Burbunëvet!

ARGATI 1 - Ku ishën fshehur?

MAS' SHAVERI - Kazallot!

TË GJITHË - Kazallot?

MAS' SHAVERI - Oraëj!

JAPKU - Rrëfyej, rrëfyej..., mas' Shave'!

MAS' SHAVERI - Kur Pjediskalci ish e vej e prisëj Pilon, arrënë te Kryqja e Palermës, përpoqi të parët arbëreshë çë prireshin tue rrjedhura se ish e arrëjën Burbunët. U pruar edhe ai, se ish pa armë si gjithë tjerët. Ngë dij ku kish të vej, kur e qëndron Nini Petrotta. Ky i thotë se Rozolino Pilo ish e vej e fshihej përjashta... Kazallot e ashtu edhe ai vate atje...

LLORENCI - Thonë se Rozolino Pilo ish e vij te Hora me dyqind patriotë...

MAS' SHAVERI - Ma kush e thotë! Ishën ndo dhjetë: krerat e rivoltës... çë dyqind!

LLORENCI - Si bëhet një rivoltë vetëm me krerat!

MAS' SHAVERI - E çë të duket se vetëm kishën t'e bëjën? Ti e di sa janë në alarmë edhe nani? Sa ti thua "vemi" e dyqind, pesëqind, dymijë të vijën prapa!

LLORENCI - "Mushti"?

MAS' SHAVERI - Oraëj, "mushti"!

NONI JAPK - Nga, thom u, nga, këtë fjalë kish' të zgjidhjen?

“Mushti”! E ushtarët pinë gjithë verën, megjthëse na te shtëpia jonë ngë kishëm më! Pinë gjithë verën e Horës! E për më’ lik çajtën edhe butet, çë dukej sikurse Horën ish e e mirrëj përmbytja e... verës!

ARGATI 1 - Nga, përçë “mushti”?

MAS’ SHAVERI - Përçë “mushti” litisht vje’ më thënë “mosto”, por - mua m’e kallëzoi avukati Pjediskalci - vje’ më thënë edhe “fermento”. “Il fermento”! E pra si kundërfjalë ke t’i shtosh fjalën “zien”: “mushti zien”! Ashtu si zien mushti, ashtu ziejëm na! E në ti mbyll me tape butet kur mushti zien, çë streks (ndodh)?

JAPKU - Se butet shkatarrjën (shpërthejën)!

MAS’ SHAVERI - Bravo djali! Ashtu burbunët mbylljën butet e ato... bum! (*Bën gjestin përkatës.*)

NONI JAPK - Burbunët ngë mbylljën butet: pinë verën e atë çë ngë pinë e derdhën te dheu, veç se çajtën gjithqish!

LLORENCI - Mas’ Shave’, ti e di e glatë (glatë)! Nani të pyenj: përçë kur Burbunët gjegjën fjalën “mushti” kërkuan te butet?

MAS’ SHAVERI - Nga, se ndëlguan se armët ishën fshehur te butet! (*Qeshjën.*)

JAPKU - E kush ja zbëloi atyreve?

MAS’ SHAVERI - I zbëloi çë?!

JAPKU - Nga, fjalën “mushti”!

MAS’ SHAVERI - E kush e di. Ata kanë spiunë ku isht isht... Ndo mik i Burbunëvet e gjegji e vate ja tha...

LLORENCI - Bukur fugurë ç’i bënë t’e mirrjën me butet!

Skëna e tretë - ATA, KURIQI

KURIQI - (*Hyn i trëmbur nga rrugica e thërret për kushtrim*) Burbunët! Burbunët! Jan’ e vijën pameta! Arrunë te Fusha e Pontit! (*Gjithë ngrëben shtuara e vrehen të dyshimtë.*)

LLORENCI - Sa janë?

KURIQI - Një luzmë! (*Burrat dal’e dalë shpërndahen.*)

LLORENCI - Çë duan pameta!?

MAS’ SHAVERI - Hyni, hyni brënda! Na (*Argatëvet*) vemi te shtëpitë tona: kemi të mbahemi me shëndet për ditë më të mira!

ARGATI 1 - Vemi...

ARGATI 2 - Vemi...

NONI JAPK - Pameta?! E çë duan?!

KURIQI - (*Qesh me gaz të lartë*) Ah! Ah! Ah! Ju bëra një lodrë!
(*Gjithë qëndrojnë.*)

LLORENCI - (*Hidhërohet*) Në të vë duart ngrahë! (*Djali jik në shtëpi e i jati prapa; pra ndihen shpëllakat.*)

NONI JAPK - I vuri duart ngrahë!

MAS' SHAVERI - Le, Llore', le... se fëmijë ë!

NONI JAPK - Mos i fort (e rrah)! Le të jesë...

MATIEJA - (*Nga brënda shtëpisë Llorencit*) Le... le... se ti ke duart të thata!

JAPKU - Ashtu mësohet!

MAS' SHAVERI - Me të vërtetë, këto lodra ngë bëhen!

NONI JAPK - Fëmijë... çë do! Le... Llore'!

LLORENCI - Ja mësonj u atij! (*Del.*)

La'JAPKU - Çë e çunkarte (i bëre të keq)?

ARGATI 1 - Fëmijë: çë kemi t'i bëjem! (*Dalë e dalë ulen te vendet ku ishën më parë.*)

MAS' SHAVERI - Ngë bëhen këto lodra!

ARGATI 2 - U trëmbe, mas' Shave'?

MAS' SHAVERI - Jo se u trëmbe... E pra ngë mënd të ish vërtet se Burbunët vijën pameta?

LLORENCI - E ndreq u atë!

NONI JAPK - Mah, shpresojëm të mos të jetë ajo bëzonjë!

MAS' SHAVERI - Çila bëzonjë?

NONI JAPK - Lloreu... të ndreqënj të birin! Ngë arrën se jam u i kurrusur?!

MATIEJA - (*Nga brënda shtëpisë, ndërsa Kuriqi vëhet si piull*) Qetu, qetu se ngë të vrau! Qetu... Njatrë herë ngë e bën më!

ARGATI 1 - Burbunët! Ëh! Djalit i pëlqen të na trëmbënj...

ARGATI 2 - U trëmbëm gjithë, por më shumë mas' Shaverit!

MAS' SHAVERI - Ngë ë vërtet! U di çë vje' më thënë në burbunët vijën pameta!

ARGATI 1 - E për një të imtë (mument) ndëlgove se ish'e vijën!

MAS' SHAVERI - U e di që vje' më rarë! Ju e dini ku ë Pjediskalci e Rozolino Pilo? Jo! E atëherë mos flitni!

ARGATI 1 - E ku janë?

MAS' SHAVERI - Ngë mënd t'jue thom! U drenë (druajtjen) e mora për atal

LLORENCI - *(Ende i tërbuar)* E mësonj u atë!

MATIEJA - *(Del me Kuriqin që ka një fashë rreth kokës. Llorencit i thotë)* E sheh se i çajte kryet? I dolli gjak!

LLORENCI - *(Më pak i tërbuar)* E ndreq u atë!

NONI JAPK - *(Flet me Kuriqin)* Eja këtu, nipi jim... Eja te noni...

KURIQI - *(Ndërsa Matieja hyn te shtëpia)* Jo!

NONI JAPK - Eja e t'uju me ne: nani edhe ti ke kryet të çarë! Në të sheh avukati Pjediskalci thotë se edhe ti je patriot! Eja këtu e bëj paqë me tët at!

KURIQI - Jo! *(Por qaset.)*

NONI JAPK - *(Sapo qaset më shumë e rrëmben)* Bëj paqë me tët at!

KURIQI - Jo! *(Pra rend tek i jati e e përqafton.)*

NONI JAPK - E sheh, Llore', disa herë bën të ligun, por pran...

ARGATI 1 - Bëhet si një kaqic!

MAS' SHAVERI - Edhe pak e këto lodra djali ng' i bën më, në, si kemi thënë, Burbunët kanë zjarrin te bishti!

Skena e katërt - ATA, KARAVÀ

KARAVÀ - *(Hyn nga rrugica)* Që bëni këtu!

ARGATI 1 - Oh, Vito Karavà! Të shkuan dhëmbjet te eshtrat? *(Karavau ka ndonjë lavomë, por s' ka fashë.)*

KARAVÀ - Mua më shkojën nijize: shkupinjtë marrë për idenë e Italjes janë dhelka për mua! E ju që bëni?

LLORENCI - Që kemi të bëjmë: pa shërbëtyrë ishëm e pa shërbëtyrë jemi; në mes i shton se klemë (qemë) rrahur mirë nga Burbunët!

KARAVÀ - Këto shërbise ngë harrohen. Ju jini patriotë, megjithëse avukati më tha se ngë doni të mirrni pjesë...

ARGATI 2 - Jemi patriotë të rizervës: kur ë ndonjeri që ka marrënj shpëlaka i vemi na!

KARAVÀ - Jo, ashtù jo... E me kaq, ju kish' t' ishët të parët që kish' t' ngrëjët kryet e kish' të spastrojë atdheun nga këta njerëz pashpirt!

MAS' SHAVERI - Sa herë ja kam thënë këtyre miqve këtu: po ngë duan të gjegjen! Burbunët ngë i kanë dhënë gjë; Italja e re i jep gjithqish!

LLORENCI - Jo, na ngë duam gjithqish, se me gjithqish ngë rrohet; na duam dhera, duam punë...

KARAVÀ - E punë do' të kini!

KURIQI - (*Prek kokën*) 'Ai!

KARAVÀ - E djali që kal? Edhe me fëmijën e morën?

LLORENCI - E morën kush?

KARAVÀ - Si kush! Burbunët!

NONI JAPK - Djali i shkuli për... Burbunët e andaj i ftesjën burbunët në ka kryet të çarël!

KARAVÀ - (*Qaset te djali*) Klenë (qenë) ata gjinde pa zëmër?

KURIQI - Jo, kle tata !

KARAVÀ - Yt at? Nga, thotse i shkule për Burbunët!

KURIQI - Lurita se ishën e prireshin pameta... e tata Burbunët m'i dha te kryet!

KARAVÀ - Ah... ah...! Ashtù i ftesjën Burbunët!

KURIQI - O, 'strote qesh... por mua më dhëmb kryet!

KARAVÀ - Eh, se të shkon: një patriot i vogël si ti, që i shkuli për faj të Burbunëve, ngë ka dhëmbet!

MAS' SHAVERI - (*Karavant*) E ti si kle këtej?

KARAVÀ - Kemi shërbise të reja. E xutë se zonjat që konti Marullo kish marrë peng i prunë pameta te Hora?

LLORENCI - I prunë pameta?

KARAVÀ - Eëj. Marullo i kish qellur Palermë mbi karretin (qerren) e i bëri të shkojën në mes fulës ngjera te Piazza Bolonjil! Ndërsa ato prisjën atje, Marullo vate te gjenerali Salzano t'i rrëfyej të bëmat e mëdha që ai kish bërë; se patriotët ngë i kish gjetur, për se mori si peng disa arbëreshe, zonja e gra të popullit, gjiri të patriotëve. Kur Salzano gjegji këtë nduhtë (lajm) jui ngjyp gjaku te kryet e i luriti se në vend të luftoj kundra patriotëve, luftoi tundra gravet... e i urdhëroi t'i dërgoj nijze nijze te Hora...

TË GJITHË - *(Të gëzuar)* Mirë bëril!
 MAS' SHAVERI - E ë kjo nduhta e re?
 KARAVÀ - Të duket pak?
 MAS' SHAVERI - Jo, por...
 KARAVÀ - Kam ca më të reja...
 LLORENCI - Çilat?
 KARAVÀ - Pjediskalci ë te Hora!
 TË GJITHË - Ë pameta te Hora?
 KARAVÀ - Ëj!
 LLORENCI - E nani?
 KARAVÀ - Qaset hera e...
 MAS' SHAVERI - E u çë ju thoshja? Hera qaset e kush ë burrë...
 LLORENCI - Kush ë burrë çë bën?
 MAS' SHAVERI - Jo burrë... burrë! Dej' të thoshja: patriot, përçë
 për mua patriot e burrë ë gjithë një fjalë!

Skëna e pestë - ATA, ZALLAPÌ, BENIÇI

ZALLAPÌ - *(Nga rrugica me Beniçin, të veshur të dy me pethka bulqish.)*
 Duket se jini heronj!
 BENIÇI - Patriotë!
 NONI JAPK - E këta kush janë?
 ZALLAPÌ - La' Japku, ngë më njeh? Jam Lluixhi Zallapì!
 BENIÇI - E mua? Jam Gjusepi Beniçi.
 LLORENCI - E përçë u veshët kështu?
 ZALLAPÌ - Sa të mos na njihjën ushtarët burbunë.
 NONI JAPK - Bëtë mirë. Dukij vërtet bulq!
 LLORENCI - Vërtet bulq... Ëh? Sa ndërrojën pethkat duken si
 na; por abrënda janë kush janë!
 BENIÇI - Zëmra jonë ë me jul!
 LLORENCI - Zëmra!
 NONI JAPK - Më pëlqen se u veshët kështu. Ju jini djelmë të
 ndermë. Sa janë çë vishen si na sa të na hanë mish e shpirt! Ata ngë
 mënd t'i shohl! Por ju jini djelmë të mirë e kur flitni e bëni me zëmër.
 ZALLAPÌ - Noni Japk, shërbiset kanë të ndërrojën e ka të vinjë

dita që argatët e punëtorët kanë të marrjën pushtetin, me shpresën sa të mos na hanë ata mish e shpirt atëherë!

LLORENCI - Urin e kemi, po jo aqë të fortë të hamë gjinden!

KARAVÀ - (*Zallapiut e Beniçi*) Të reja?

ZALLAPÌ - Jerdhëm të ju thoshjëm se Pjediskalci ë këtu te Hora.

BENIÇI - (*Vren djalin*) Djali që pati?

NONI JAPK - Burbunët...

ZALLAPÌ - Klenë ata?

LLORENCI - Jo, por i ftesjën ata!

BENIÇI - Edhe me fëmijët e marrjën? Kanë të paguajën edhe këtë! Llorë, u jerdha të ju haristisja (falëderoja) për sa bëtë për mëmën e për time motrë.

LLORENCI - Më dishpëlqen se i gjetën... Kurrë më parë kishën kërkuar te shtëpia jime!

ZALLAPÌ - Vje' më thënë se drenë (druatjen) ata e kanë aqë e fortë se i trëmben gjithnjëriul

BENIÇI - Mëma e jime motrë u prorën pa dëm nga Palerma. Më truajtën të ju haristisja. Kini të falat nga avukati. Në dijët që ka bërë ai te malet rreth Palermës, kish' të qëndrojët me gojë të hapët!

NONI JAPK - Rrëfyey... rrëfyey....

BENIÇI - Ashtù, tue rrjedhura, se kemi të vemi...

Skëna e gjashtë - ATA, DY BURRA, ÇENCINA

ARGATI 2 - Ei, vreni këtë... (*Shënon rrugicën ku shkojën dy burra me vo' Çencinën më duar. Bëhet heshtëje.*)

BENIÇI - (*Me zër të ulët*) Kush ë?

LLORENCI - (*Tuke pëshpëritur*) Vo' Cençina! Burbunët e lanë gjymsa vdekur!

ZALLAPÌ - E si?

LLORENCI - Vanë te shtëpia e saj, se ndonjeri zbëloi se ish patriote. Burbunët kërkojën të dijën nga ajo emret e kreravet e te ku gjëndeshin. Ajo ngë ja zbëloi. Atëherë e lidhën me një tërkuzë, e ngrëjtën dy pëllëmbë nga dheu, i vunë përposh xhëllonës një brazherë plot me zjarr e mbi zjarrin shtunë ca pluhur që si shkrepit i dogji mishtë të mjerës...

BENIÇI - E kështu Burbunëvet u shtohet numëri i dëtyravet që kanë të paguajën!

ZALLAPI - Të poshtër! (*Ndërkaq dy burrat e gruaja shkuan.*)

NONI JAPK - (*Me pjesëmarrje*) Çencina ë një patriote e madhel Por zoti Beniçi ish e na rrëfyej për avukatit...

BENIÇI - Avukati ka kryer të bëma heroike! Patëm urdhër nga patriotët maxinianë të mbajëm dhezuar zjarret te picet (majat) e malevet që ndodhen rreth Palermës. Avukati ish atje e sa herë qasej ndonjë grumbull ushtarësh burbunë, ai i dilëj përpara... Ish shpirti i atyre zjarreve! Nga Palerma natën ata zjarre mblejën si hërnare të mbëdhenj, t'u kujtojën burbunëvet se atje sipër ndodheshim na. Edhe nani i dhezjën nga mbrëma!

KARAVÀ - Ë mirë të vemi: këtu gjithë bashkë ngë mënd të rrimël!

ZALLAPI - Vemi. Llore', e ju të gjithë, kujtoni se hera po qaset!

KARAVÀ - Rroftë Bashkimi i Italjes!

BENIÇI - Rrini me veshët të zbyllmë si dhelprat kur ndëlgojën se gjagjë lëviz... (*Patriotët nisen*) Qevarrisu!

NONI JAPK - Qevarrisul

MAS' SHAVERI - Djelmë të rrallë!

NONI JAPK - Kushedi sa kanë t'i lënë gjellën për këtë Italje!

MAS' SHAVERI - Sa më thonë "vemi", u vete!

ARGATI 1 - Me rrazollin?

MAS' SHAVERI - Me rrazollin o me që isht isht... Armët ja marrjëm burbunëvet!

JAPKU - Edhe u dua t'i vete!

LLORENCI - Ti? Ti ngë vete mosgjakun!

JAPKU - Ta', u kam gjashtëmbëdhjetë vjeç e ka një gjellë e tërë që pres... gjagjë!

ARGATI 1 - Pa gjegj... pa gjegj!

MAS' SHAVERI - Bravo! Ti ëj se do të ndërrosh jetën!

LLORENCI - Ti ngë ke ku të veç; je i vogël... E pra kush të tha të gjegjeshe diskutet e të mbëdhenjvet!

MAS' SHAVERI - Nga, përçë ë i math! Shkopatat nga burbunët i pati edhe ai; ka liq të dishironj të ja shkëmbenj te kurrizi i tyre!

LLORENCI - Mas' Shave', ti sa ka që të morën rrazollin nxier po fjalë e po fjalë!

MAS' SHAVERI - Ngë ë ashtë... Sot gjithë ata çë ngë mënd të durojën këtë gjellë kanë po sa rrëmbejën armët! Ti thua se ngë ë rivoluziona juaj. *Illuso!* Kjo rivolucionë ë edhe ajo juaja; pra si sos bëhen kundet; kush ka të ketë e kush ngë ka të ketë!

LLORENCI - Ti e ata kini idealet! U kam vetëm këtë gjellë, pa shërbëtyrë e shtëpia jime pa bukë!

MAS' SHAVERI - (*Bën sikur të niset*) Ata, patriotët, të japjën garanci!

Skëna e shtatë - ATA, PJEDISKALCI, SULI

PJEDISKALCI - (*Nga rrugica me Sulin, të dy veshur si bulq*) Kush flet për garanci?

MAS' SHAVERI - Oh, avukati! Kush ngë vdes shihet pametal!

PJEDISKALCI - Me qëronjet çë janë, ë një mrakull në shihemi!

LLORENCI - T'uju avukati.

PJEDISKALCI - Pë' çë flisjët ?

MAS' SHAVERI - Lloreu do garanci.

PJEDISKALCI - E ndëlgova. Eh, Llore', si shoh jui kërsitën...

SULI - Edhe djalit ?

LLORENCI - Jo drejt për drejt, por i ftesjën ata...

PJEDISKALCI - E zotrote, la' Japku, e shoh më kopill!

NONI JAPK - Kam të haristis kurën e Burbunëvet! (*Bën gjestin e të rrahurit.*)

PJEDISKALCI - Ngë patën nderë për zotrote, ëh?

NONI JAPK - O, ashtë e patën... se më fortën (rrahën) vetëm te kurrizil! U ja lypa: "këtu... fortini këtu!" e ata më morën vesh!

PJEDISKALCI - Më dishpëlqen se e morën me ju; e megjithatë u dëftuat patriotë të vërtetë!

MAS' SHAVERI - Zoti avukat, çë të reja kemi?

PJEDISKALCI - Si nani kemi mbajtur zjarrin...

NONI JAPK - Na e rrëfyeti zoti Beniçil!

PJEDISKALCI - Ah, ju thoni për zjarret rreth malevet të Palermës! U thom zjarrin e patriotizmit: po qaset heral Itaj thërret bijtë e saj më të mirë! Kush ka krah të fortë ka të ja huanjë! Kush te

zëmra ndien edhe një thërrime dashuri për atdheun, ka sa ngrëhet e merr armët! E armët jan' e arrëjën! Kush e di në kemi t'e shohjëm këtë Italje të re! Sot jemi këtu që flasjëm ndër nesh e nesër mënd të jetë se një balë të na shuanjë gjellën! Por ju ka dini se një poet grek këndoi kështu: "Bukur ë të vdiset për atdheu e dashur!" (*Ghjithe mallëngjehen*) E në kam të vdes nesër, di se vdiqa për Italjen!

LLORENCI - Të bukura janë fjalët!

PJEDISKALCI - E ti, mbre Llore', do garanci! Cilat u e di mirë; po kush sot mënd të t'i japën? Mbre Llore', në ngë bëhet nani kjo rivolucionë, ngë mënd të bëhen të tjerat! Sot ka të bëhet kjo të ndërrohen shërbiset!

LLORENCI - U ngë thom jo, se ngë kanë të ndërrojën; por si kanë të ndërrojën! Nxierjëm një mbret e i vëmë një tjetër; nxierjëm një gomar e i vëmë një tjetër? E këtë, Garibaldin, kush e thërriti?

SULI - Atë e thërritëm na! Ti e di mirë që ka bërë ai në Amerikë; por ngë kemi mbëhi të vemi ashtu llargu!

LLORENCI - Atë që ka bërë e dimë mirë gjithë; po të vapqit (varfërit) ka mot e monë që qëndrojën të vapqë (varfër)!

PJEDISKALCI - Këtë herë ngë do t' jetë ashtu; këtë herë shërbiset kanë të ndërrojën!

SULI - Në ju doni të jini me ne, na duam të jemi me ju: të lidhur bashkë!

Skëna e tetë - ATA, XH. KASARÀ, K. BENIÇI, MATIEJA

ARGATI 1 - Llore', ti që tua: jan' e vijën këtu ato gra? (*Sbënon me kokë rrugicën.*)

LLORENCI - E u që dil!

Xh. KASARÀ - (*Sapo janë ndanëz*) Mirë ditël!

TË GJITHË - Mirë ditël! (*Pjediskalci e Suli ngrëben e i falen. Tjerët qëndrojën ulur, por në mënyrë edukate.*)

LLORENCI - Matie, shih se ë zonja Jakine e zonja Kunçetël (*Ngrëbet dhe i shoqëron te shtëpia.*)

MATIEJA - (*De!*) Oh, zonjat Hyni, hynil! Ish e laja dheun... por ju hynil!

Xh. KASARÀ - Në ish e laje, ngë hyjëm... e pran ngë mënd të rrimë shumë...

MATIEJA - Do' t' ujj këtu jashtë? Ju marr dy frone...

K. BENIÇI - Jo, jo, shtuara shtuara. Erdhëm të ju haristisjëm.

MATIEJA - Nga, përçë: na bëmë gjithë atë çë mënd të bëjëm!

Xh. KASARÀ - E dimë... e dimë... Ju ngë i ftisni në na gjetën...

MATIEJA - Kish' t'ju kishëm fshehur më mirë!

Xh. KASARÀ - Ngë i bën gjë; dollëm pa dëme, ngë i bën gjë...

K. BENIÇI - (*Dëfton një borsë*) Ju prumë dy shërbise...

MATIEJA - (*Vren borsën*) Oh, çë jini...! Nga çë mbëhi kishët! Çë bëzonjë kishët!

Xh. KASARÀ - E dimë se si nani ngë e shkoni mirë; yt shoq pa shërbëtyrël Mah, qëronje të ligj për gjithël

MATIEJA - E më shumë për ne! Për ne ë gjithmonë mot i keq! Mah! Ngase ç'do t' i bëjëm! (*Merr borsën*) Nga, çë bëzonjë kishët! Kur ju morën Burbunët, qëndruam lik lik! I thoshja tim shoqi: kush e di ato të mjera ku u panël Mah, për fat të mirë nani jini pameta te shtëpia juaj!

Xh. KASARÀ - Të haristisjëm shumë shumë!

K. BENIÇI - Ju haristisjëm gjithëve!

Xh. KASARÀ - Ti ishe laje... na vem! (*Qaset e puth Matien e ashtë bën edhe K. Beniçi.*)

K. BENIÇI - Qevarrisul!

MATIEJA - (*Mallëngjebet*) Qevarrisul!

Xh. KASARÀ - E djali çë kal?

LLORENCI - I pati...

K. BENIÇI - Edhe me djalin e morën?

LLORENCI - Ata i ftesjën!

Xh. KASARÀ - Qëronje të ligj! Edhe fëmijët sot ngë janë më të ruajtur! Mah! Qevarrisul!

K. BENIÇI - Qevarrisul (*Dajën si zonja.*)

Skena e nëntë - ATA

MATIEJA - Oh, zoti avukat! Mirë se na u prore!

PJEDISKALCI - Vo' Matì! (*Qaset e i shtrëngon dorën.*)

SULI - Falem vo' Matì! (*I shtrëngon dorën.*)

MATIEJA - T'ujj! T'ujj! U vete sos të larit. (*Hyn te shtëpia.*)

MAS' SHAVERI - Gra me vlerje tonat, e arçere!
 PJEDISKALCI - E i biri, Gjusepi, ë një patriot i dhezur!
 MAS' SHAVERI - E dini se jiku nga siminari Palermë të shkojë me patriotët!
 NONI JAPK - Kush!?
 MAS' SHAVERI - Gjusepe Beniçi: jiku ka siminari Palermë!
 PJEDISKALCI - Ë një kopil i rrallë! Mbre' Llore', të thoshja se ju doni mos doni jini me ne! Tyj të lypset një thërrime entuziazëm...
 LLORENCI - Zoti avukat, u entuziazmin e kam; ke të më shohësh te puna...
 PJEDISKALCI - E di, e di! U thom entuziazmi i patriotit...
 LLORENCI - E çilin entuziazëm mënd të kem! Si duhet t'i japjëm të ngrënë këtij entuziazmi, në më parë ngë i kemi dhënë të ngrënë bijvet! Ngë thom për mua... se mua edhe ajri më arrën (mjafton), por bijvet! Në kisha punë, në këta si u kishën punë (*Shënon argatët*), i jipjëm të ngrënë edhe patriotizmit!
 PJEDISKALCI - E di, e di! Por shërbiset kanë të ndërrojën. U jam i sigurt se shërbiset kanë të ndërrojën! E në qëndronj gjall, rri i sigurt se më ke te ana: dherat kanë të jenë për ju...
 LLORENCI - Haristis për fjalët...
 PJEDISKALCI - Eh! Ti, Llore', ke ironinë te gjaku: më haristis për fjalët! (*Buzëqesh*) E ke liq, se si nani vetëm fjalë mënd të të jap!

Skëna e dhjetë - ATA, BELLO

BELLO - (*Rrah tumbarinin e pra këndon*) "Gjinde kush ngë më njeh ngë di kush jam... e kush më njeh ngë ka bëzonjë të ja thom uuuuu!!!"
 KURIQI - (*Gëzohet*) Tumbarinari!
 LLORENCI - Ë Pjetri Bello!
 PJEDISKALCI - Xura se i shkuli edhe ai!
 BELLO - (*Hyn me fytyrë plot me lavoma*) Oh... oh... oh... zoti avukat Pietro Pjediskalci! (*I bie tumbarinit*) Rroftë *l'Italia*! Rroftë Gharibaldi! Rrofshin patriotët tanë arbëreshë!
 SULI - Qetu, qetu, mosnjeri e di se jemi këtul
 BELLO - Lyp ndjesë, zoti avukat, lyp ndjesë... Por në mosnjeri e

di se jini këtu, edhe kur u të bandjar se jini këtu kush më ka besë?

PJEDISKALCI - Tyj të kanë besë: je bandjatori!

BELLO - Eh, si nani mosnjeri më ka besë!

PJEDISKALCI - Përçë!

BELLO - Përçë gjithë urdhërit çë bandjar, i bandjar kështu (*Me zër shumë të lartë*): “Për urdhër të Komitatit patriotik të Horës...”

SULI - E në të gjegjen?

BELLO - Kush?

SULI - Nga, ushtarët burbunë çë qëndruan te Hora!

BELLO - Ata janë të shurdhër! Eh, zoti avukat, nani ngë kam më zër...

PJEDISKALCI - Jo se e ke!

BELLO - Jo, ngë kam më zër te kapitulli, *vuci in capitulo*, përçë mosnjeri më ka më besë! Edhe burbunët ngë më kam besë...

SULI - Më mirë ashtù!

BELLO - E për mua o ndërrojën shërbiset o shes tumbarinin!

PJEDISKALCI - Mos e shit, se ke t'i biesh pameta për ne: qaset heral! Edhe pak e pra mënd t'i biesh e të bandjarësh sa të duash!

BELLO - T'u lumtë goja, zoti avukat! E kam gjithë te trutë!

SULI - Çë ke te trutë?

BELLO - (*Këndon*) “Për urdhër të Komitatit patriotik të Horës... gjithë ato fixhë (fytyrë) murtizi Burbunësh kanë të ven'e shtihen gjithë te gorromina e Honit!” (*E rrah tumbarinin.*)

Skëna e njëmbëdhjetë - ATA, PETROTTA, BENIÇI

PETROTTA - (*Nga rrugica*) Oè, gjinde, avukati aty ë?

PJEDISKALCI - Këtu jam, Ni! Të shoh i gëzuar: çë streksi?!

BENIÇI - (*Nga rrugica me Petrottën*) Jemi gjithë të gëzuar!

PJEDISKALCI - Të reja?

PETROTTA - Mënd të flas o t'e thom te veshi?

PJEDISKALCI - Në ë shërbes vetëm për mua m'e thua te veshi, në ë shërbes i gjithëve e thua me zër të lartë!

BENIÇI - Kemi sa e lurijëm!

PETROTTA - (*Flet me Beniçin*) Ja thua ti o jam thom u?

BENIÇI - Thuaja ti, se ti arrure i pari...

PETROTTA - Në do të ja thuash ti, u shtyhen prapa!

PJEDISKALCI - E çë pritni! Mos na leni kështu te glëmbat!
Flitni!

PETROTTA - (*Tuke shqiptuar mirë*) Ga....ri...bal...di! Garibaldi
zbarkarti Marsallë!

PJEDISKALCI - Vërtet?

BENIÇI - Garibaldi zbarkarti Marsallë!

PJEDISKALCI - Garibaldi! Burra: Garibaldi zbarkarti! E dini çë
vje' më rarë? Se jerdhi hera!

BENIÇI - "Mushti"! Mushti ziejti! E nani zë festa!

LLORENCI - "Mushti": ish ky mushti?

PJEDISKALCI - Llore': jerdhi hera! (*Patriotët përqafohen.*)

Skëna e dymbëdhjetë - ATA, ZALLAPË

ZALLAPË - (*Vjen nga rrugica*) E dini... e dini?

PJEDISKALCI - (*I gëzuar*) E dimë! E dimë! (*Përqafohen me
Zallapium.*) Llore', e ju miq, na vemi të organizohemi! Ë heral Ju
(*Llorenci e argatët*) ngë kini shumë qëro t'i vëni mendje. Sonte,
nesër... ca nisen të bashkohen me Garibaldin. Na qëndrojëm te
malet rreth Palermës të përgatitjëm dheun, të sheshojëm rrugën...
se kur vjen ai ka të gjenjë gjithqish më të lehtë!

BELLO - E u çë ka bandjar (lajmëronj)?

PJEDISKALCI - Ngë the se mosnjëri të ka besë!

BELLO - Ë kush ngë më ka besë e ë kush më ka besë. Patriotët
më kanë besë!

PJEDISKALCI - E ti bandjar se Garibaldi zbarkarti!

BELLO - Se zbarkarti Marsallë! Marsalla ë vera më e mirë çë kam
pirë e në më gjegjen Burbunët kanë të thenë se jam po një i dejmë
(dehur)!!!

PJEDISKALCI - Mirë, bëj ashtul Llore', na vemi... Kur shihemi?

LLORENCI - Njizel

PJEDISKALCI - E dija se je... se jini (*Shënon argatët*) patriotët!
Vemi kopij!

PATRIOTËT - Vemi!

BELLO - Mban! Gjegjni më parë këtë: “Për urdhër të komitatit patriotik të Horës... Garibaldi zbarkarti Marsallë!” (*E rrrah tumberinin.*) Vete mirë?

PJEDISKALCI - Thuaje si të duash! Komitati i Horës... që i urdhëron Garibaldit të zbarkarënj! Mirë e the! Vemi! (*Patriotët nisen me Bellon që lëçit e rrah tumberinin.*)

Skëna e trembëdhjetë - ATA, PILJA, GATUCA

NONI JAPK - E zuri festa! Llore' ju që kini të bëni!

LLORENCI - (*Vren tjerët*) Vemi: ngë mënd t'i lëmë....

ARGATI 1 - Ngë mënd t'i lëmë vetëm kopijtë e Horës!

ARGATI 2 - Në ngë i vemi na, kush ka t' i ve'!

JAPKU - U vinj me ju!

LLORENCI - Ti jo: të thashë se je i vogël!

JAPKU - Ngë jam i vogël!

LLORENCI - Qetu e bëj si të thom u: ti ka ruash tët ëmë e tët vëlla!

NONI JAPK - (*Me shprehje*) E nonin?

LLORENCI - E nonin! Bashkë me nonin një burrë tjetër te shtëpia i duhet!

MATIEJA - Ish e laja e ngë dolla; që kle me gjithë ato thirrma!

PILIA - (*Vjen nga rrugica*) Që streksil!

LLORENCI - Garibaldi zbarkarti Marsallë!

MATIEJA - Garibaldi?

PILIA - Garibaldi?! Nani vete ja thomë djemvet! (*Niset.*)

GATUCA - (*Nga rrugica*) Që ë, që kle!

MATIEJA - Garibaldi zbarkarti Marsallë!

GATUCA - E zuri festa!

NONI JAPK - “E zuri festa” e thashë u!

GATUCA - Vete e ja thom tim shoqil! (*Niset.*)

LLORENCI - Matie, përgatit trastën, me një këmishë...

MATIEJA - E që ka i veç?

LLORENCI - Eëj, kam t' i vete...

MATIEJA - E u qëndronj vetëm?

LLORENCI - Ke Japkun, Kuriqin...

NONI JAPK - E u çë jam mosgjë?

LLORENCI - E nonin...

ARGATI 1 - Vete marr trastën...

ARGATI 2 - Edhe u. (*Argatët venë. Llorenci e gjithë familja hyjnë te shtëpia. Bëhet heshtje.*)

Skena e katërbëdhjetë - LLORENCI, MATIEJA, NONI JAPK,
JAPKU, KURIQI, ARGATI 1, ARGATI 2

LLORENCI - (*Del e pas vjen e shoqja, fëmijët e noni Japk*) Vete...

MATIEJA - Ruaju!.. (*Përqafohen.*)

NONI JAPK - Mbani lart nderjen e Horën, ëh! (*Përqafohen.*)

ARGATI 1 - (*Nga rrugica me Argatin 2*) Vemi Llore' se na presjën...

ARGATI 2 - Shihemi me shëndet!

MATIEJA - (*Të shoqit*) More gjithqish?

LA' JAKU - E çë ki' të mirrëj: pajën?

LLORENCI - Ëj, mora gjithqish! (*Push të bijtë e largohet, ndërsa ata çë qëndrojnë i falen me dorë.*)

MATIEJA - Pririj! Ëh!

NONI JAPK - Në priren... çë nisen më!

MATIEJA - Ngë thom nani; kur mundjëm Burbunët!

NONI JAPK - Pririj me nderë!

PELHURA

PIETRO PIEDISCALZI. Lindi në Piana dei Greci më 13 nëntor 1825 nga Gjergji e nga Provvidenza e markesëvet Anfossi. U kushtua studimevet me përfitim e mori diplomën e teknikut bujqësie (*G. Costantini: Sessanta giorni di storia, p. 110*). Shih edhe: *G. Bennici - Un primo libro...*, p.75.

Patriot, pas dështimit të revoltës së Ganças, më 4 prill 1860, u strehua në fushat përreth Palermos, duke mbajtur gjithmonë të gjalla te populli shpresat e një kryengritjeje të re. U bashkua me *Rosolino Pilo*-n e me *Giovanni Corrao*-n, pararendës të Njëmijve, e me ata bëri çmos për të lehtësuar marshimin e Garibaldit. Vdiq duke luftuar kundër Burbonëve, në lagjen *Lenzjiti*, afër Monrealit, më 21 maj 1860, pa pasur mundësinë të shihte hyrjen e Garibaldit në Palermo.

GIOACCHINO PETTA (sec. XIX). Noter. Shkroi *Piana dei Greci nella rivoluzione siciliana del 1860 - Palermo, Tip. Clamis e Roberti, 1861*.

GIORGIO COSTANTINI (1838-1916). Mësues e historik, u formua te Seminari greko-arbëresh i Palermos e më 1905 botoi në Palermo *Sessanta giorni di storia dalla venuta di Rosolino Pilo in Sicilia alla presa di Palermo* mbi pjesëmarrjen e Horës së Arbëreshëve në revolucionën e 1860. Autor të disa vjershave arbërisht shkroi edhe: *Discorso inaugurale intorno al monumento innalzato a Giuseppe Garibaldi; Cenni storici - Origine degli Albanesi; Monografia di Piana dei Greci; Cenni della vita e delle opere di Padre Giorgio Guzzetta*. Këto shkrime mbledhur në një vëllim u botuan më 2000 te seritë e Biblos, revista e bibliotekës komunale "G. Schirò". Mbeten ende të pabotuara: *Duecento anni di storia sicula (1300- 1500); Trecento anni di storia- sicula (1016-1282); Zibaldone di notizie varie*.

GIUSEPPE BENNICI (1841-1909). Ushtar, adjutant personal i *Nino Biscio*-t, ndjekës i Garibaldit në Aspromonte, shkrimtar. Ndër të tjera shkroi poemthin *L'ultimo dei trovatori arabi in Sicilia* (1875), një *Memoria documentata sul territorio di Piana* (1874) e një vëllim të parë të *Ricordi dell'ex galeotto n. 1603* (1896) që nuk u ndjek nga të tjerë.

Finito di stampare
nel mese di marzo 2013
coi tipi della Pitti Grafica sas
con sede in Palermo
Via Salvatore Pelligra n. 6
Tel. 091.481521 - 091.6614212
e-mail: pittiedizioni@libero.it
www.pittiedizioni.it

GIANFRANCO ROMAGNOLI,
Prefetto emerito della Repubblica, è
vicepresidente nazionale e delegato per
la Sicilia del Centro Internazionale di
Studi sul Mito (CISM). Studioso di
ispanistica e di culture precolombiane,
ha pubblicato di recente *America: storia
e mito nel teatro spagnolo del Secolo
d'oro* (Palermo 2011, Carlo Saladino
Editore). Insignito del premio per la
cultura dell'Accademia Siculo-
Normanna, del Premio Internazionale
Teatro di Segesta, del Premio Socialità
e Cultura "Renato Guttuso", organizza
incontri culturali e collabora a varie
riviste. È un appassionato estimatore
della cultura arbëreshe.

Prefekt emeritus i Republikës, është
nënpresident kombëtar dhe delegat për
Sicilinë i Qendrës Ndërkombëtare për
Studimet rreth Mitit. Studiues i
hispanistikës e të kulturave parakolom-
biane, ka sapo botuar *America: storia e
mito nel teatro spagnolo del Secolo d'oro*
(Palermo 2011, C. Saladino Ed.). Ka
fituar çmimin për kulturën e Akademisë
Sikulo-Normane, Çmimin Ndërkombëtar
Teatri i Sexhestës, Çmimin
Bashkëjetesë Sociale e Kulturë "Renato
Guttuso". Organizon takime kulturore
dhe bashkepunon me disa revista.
Është çmues i flaktë i kulturës arbëre-
she.

Progetto grafico copertina
Giuseppe Stassi

Edizione
fuori commercio

ISBN 978-88-9656924-5

